



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

E.Rev.nr.26/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses: N.P.T.T., “A.Xh”, me seli në fshatin B., Komuna e K., të cilin e përfaqëson Nezir Bytyqi avokat në F., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Fabrika për Prodhimin e Ç. “Sh.C.” sh.p.k., H. E., të cilën e përfaqëson Dastid Pallaska avokat në P., sipas autorizimit, për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.306/2018, të datë 04.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.12.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditëses: N.P.T.T., “A. Xh”, me seli në fshatin B., Komuna e K., Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.306/2018, i datës 04.08.2020, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.Cnr.453/14, i datës 22.10.2018, dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, në rigjykim.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.Cnr.453/14, i datës 22.10.2018, është vendosur: I. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses N.T.P., “A. XH”, në fshatin B., Komuna e K., e paraqitur kundër të paditurit “Sh.” sh.p.k., me seli H. e E., që paditëses t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në humbjen e partnerëve të tij afarist, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuese të dhënies së hekurit, të nxjerr jashtë përdorimit, dhe fitimit të realizuar nga data 19.08.2001, deri në ditën e hartimit të ekspertizës financiare, me kamatë ligjore, duke filluar nga data 15.08.2014, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përbarimit të detyrueshëm, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv. II. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses: N.T.P., “A. XH”, me seli në fshatin B., Komuna e K., të paraqitur kundër të paditurës: “Sh. B. B.” sh.p.k., H. E., me nr. biznesi NRB - ..., që paditëses t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar material, në humbjen e partnerëve afarist, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuese, dhënia e hekurit

të nxjerr jashtë përdorimit, dhe fitimit të realizuar nga data 19.08.2001, deri në hartimin ekspertizës financiare, me kamatë ligjore, nga data e parashtrimit të padisë 15.08.2014, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, për shkak se kërkesëpadia nuk ka kurrfarë baze ligjore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore në këtë kontest gjyqësor.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.306/18, të datës 04.08.2020, është vendosur: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses N.P.T.T., "A.XH", me seli në fshatin B., Komuna e K. dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.453/2014, të datës 22.10.2018.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së dytë, shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 2 paragrafi 1 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së parë dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta pranojë revizionin e paditëses, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ae.nr.306/18, të datës 04.08.2020 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK. C.nr.453/14, të datës 22.10.2018, t'i prishë dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit, me propozim që i njëjtin të hedhet poshtë si i palejuar, apo të refuzohet në tërësi, si i pabazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, të vërtetohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditëses është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 18.08.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit, duke kërkuar më saktësisht si në kërkesëpadi.

Në seancën e datës 18.11.2016, gjykata duke vepruar sipas propozimit të paditësit, e ka lejuar zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, ku si të paditur e ka pranuar e "Sh.B. G." shpk., H. i E. me numër të biznesit ... .

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së palës paditëse, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin IV.EK.C.nr.453/14, të datës 22.10.2018, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: faturën me nr. ... të datës ... , specifikacionin e mbeturinave hekur të shitura nr. ... Ac.Kod...., fletëdërgesën me nr. ..., fletëdërgesën me nr. ..., njoftimin mbi shpalljen e pa vlefshme të kontratës nr. ... të datës ..., marrëveshjen e datës 23.04.2002, të përkthyer nga gjuha angleze,

kontratën me nr. ... të datës 18.07.2002, të përkthyer nga gjuha angleze, kontrata për shitjen e materialeve të mbetura nr. ... të datës 12.07.2004, të përkthyer nga gjuha angleze, kontrata për shitjen e materialeve të mbetura të datës 04.08.2008 nr. ..., të përkthyer nga gjuha angleze, kontrata për shitjen e materialeve të mbetura nr. ... të datës 11.03.2009, të përkthyer nga gjuha angleze, faturën me nr. ...- spec -..., të datës 15.02.2010, faturën me nr. ... - Spe.... të datës 31.05.2011, fletëdërgesën nr.... të datës 24.11.2010, fletëdërgesën nr.... të datës 10.12.2010, fletëdërgesën me nr. ..., fletëdërgesën me nr. ..., fletë dërgesa me nr. ..., fletdërgesën me nr. ... të datës 18.02.2011, fletëdërgesën me nr. ..., fletëdërgesën me nr. ..., të datës 02.03.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 03.03.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 03.03.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 21.03.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 04.04.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 15.04.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 18.04.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 26.04.2011, fletëdërgesën me nr. ... të datës 13.05.2011, transferet bankare të datës 31.12.2010, 17.06.2011, certifikatën e biznesit të “Sh. B. G.” sh.p.k., certifikatën e biznesit të “Sh. C.” sh.p.k., certifikatën e numrit fisklat të “Sh. C.” sh.p.k., faturën me nr. ... Spec. të datës 25.05.2005, transfer bankier të datës 11.02.2005, faturën me nr. ...v spec. nr. ...të datës 31.12.2008, specifikacionin e mbeturinave hekur të shitura me nr. ...dhe të datës 31.12.2008, faturën nr. ... spec. ... të datës 31.05.2001, specifikimin e mbeturinave të shitur me nr. ... të datës 31.05.2011, transferin bankar të datës 17.06.2011, transferin e datës 11.12.2009, faturën nr. ... spec. ... të datës 30.11.2009, specifikacionin e mbeturinave hekur të shitur me nr. ..., transferin e datës 30.12.2009, faturën nr. ...spec. ...të datës 18.12.2009, specifikacionin e mbeturinave hekur të shitura nr. ... të datës 17.12.2009, certifikatën e biznesit NTP., “A. Xh”, me fletat përcjellëse, lexohen 6 shtojcat e shkresës së dorëzuar nga pala e paditur të datës 20.02.2017, kontratën e privatizimit në gjuhën angleze, ekspertizën e datës 18.09.2017, e punuar nga eksperti Sh. M..

Ka shtuar se paditësi nuk ka arritur të provojë gjatë procedurës se i padituri i parë, mundet me qenë palë në këtë procedurë, ngase me provat, deklaratimet e palëve ndërgjyqës, dhe nga ekspertiza e ekspertit financiar, gjykata ka konstatuar dhe ka vërtetuar, se të paditurës së parë “N. Sh. C.” sh.p.k., i mungon legjitimiteti pasiv.

Kjo vërtetohet në faktin se kur paditësi dhe e paditura e dytë e kanë lidhur kontratën për shitjen e mbeturinave - hekurishteve, e paditura e parë “Sh. C.” sh.p.k., ende nuk ka qenë e formular. Pastaj gjykata askund nuk ka gjetur në shkresat e lëndës se ekziston ndonjë kontratë mbi cedimin, me të cilën e paditura e dytë ja ka ceduar kërkesat, apo edhe obligimet të paditurës së parë. Sipas kontratës mbi privatizimin, me nr. ..., për shitblerjen e aksioneve të paditurës së parë, më datë 09 dhjetor 2010, e njohur si Kontrata e Privatizimit, gjegjësisht në nenin V, të kontratës së privatizimit, vërtetohet se e paditura e parë kishte marr për obligim vetëm dy detyrime dhe atë: Investime në shumën prej 35 miljon euro, dhe mbajtjen në punë të 503 punëtorëve, pra asnjë obligim tjetër. Me këtë pra është vërtetuar se nga e paditura e dytë nuk ka marr kurrfarë obligimi - detyrimi për ndonjë punë tjetër juridike. Se nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje e paditura e parë “Sh. C.” sh.p.k., e forcon edhe ma tepër fakti se e paditura e dytë “Sh. B. G.”, ende është aktive, nga se është deklaruese aktive e tatimeve pran ATK-së, edhe pse të dyja këto kompani janë në pronësi të njëjtit subjekt juridik të huaj, mirëpo të njëjtat nuk kanë asnjë ndikim në personalitetin e tyre të veçantë juridik.

Paditësi gjithashtu nuk ka arritur që të provojë kërkesën e tij për dëmin që i është shkaktuar nga veprimet e të paditurës së dytë. Edhe pse qëndron fakti se e paditura e dytë “Sh.B. G.” kishte lidhur kontratë për shitjen e mbeturinave të paditëses, në kohën deri sa e kishte nënë komercializim N., “Sh. C.”, me rastin e shitjes se kësaj kompania nga AKP-ja, kjo kontratë është shkëputur, gjegjësisht, nuk ka qenë e obligueshme për të paditurën e parë, sepse e paditura e parë nuk ka pasur kurrfarë obligim ta mbaj në fuqi të njëjtën. Nga kontrata nuk shihet asnjë detyrim që e paditura e dytë ti shet në mënyrë të pakushtëzuar mbeturin - hekur paditëses, brenda ndonjë periudhe të caktuar kohore, që do të thotë se ka qenë në diskrecionin e plotë të paditurës së dytë, ngase objekt i kontratës ishin hekurishtet e vjetra të nxjerra jashtë përdorimi. Kontrata nuk parashihet as edhe detyrimin e vetëm për t’ia shitë hekurishtet në sasi të caktuara, dhe në kohë të caktuar, kur nuk dalin jashtë përdorimit, pra e tëra kjo është varur nga procesi i prodhimit. E paditura e dytë, “Sh. B. G.”, deri sa e ka pasur nënë komercializim NSH “Sh. C.”, materiali i mbetur - hekurishtet, kanë qenë nënë menaxhimit të saj, ashtu që edhe kontrata e lidhur për shitjen e hekurishteve me kompaninë “A.XH” ka qenë obliguese për të. Me rastin e shitjes së kompanisë me NSH., “Sh. C.” me Spinof special, “N. CO Sh. C.” ka marr nën menaxhim edhe fabrikën, edhe mbeturinat, që dalin nga prodhimi, ashtu që kontrata e lidhur në mes kompanisë “Sh. B. G.” dhe “A. XH”, ka mbetur pa objekt, nga shkak se objekt i saj kanë qenë mbeturinat - hekurishte, të dala nga prodhimi, andaj kur zhduket apo kur objekti i kontratës kalon në një subjekt tjetër, përveç nëse subjekti i cili është bërë pronar i pranon kërkesat dhe obligimet të dala nga ky objekt i kontratës, i pranon vet me ndonjë kontratë të re, apo me vet kontratën e shitjes. Këtu, pra në këtë çështje kontestimore nuk kemi të bëjmë me kërkesat dhe obligimet që e ngarkojnë - përcjellin objektin, edhe nëse ky kalon në ndonjë subjekt tjetër në çfarëdo mënyre, siç është rasti kur ky objekt i këtij subjekti juridik, do të ishte i ngarkuar me hipotekë, apo ndonjë barrë tjetër.

Nisur nga kjo edhe eksperti gjatë përpilimit të ekspertizës nuk ka mundur ta përcaktoj vëllimin e dëmit, që i është shkaktuar paditësit, nga se eksperti nuk ka mundur të gjejë çfarëdo dëshmie që tregon se pala paditëse ka pasur fitim të humbur. Andaj, pala e cila ka propozuar ekspertizën ka qenë e detyruar të tregoj edhe objektin dhe vëllimin ekspertizës, e nisur nga ky fakt pala paditëse nuk ka mundur të planifikoj fitim të humbur nga një punë juridike, sipas së cilës nuk ka pasur garanci, se do të blinte hekurishte në sasinë e caktuar nga “Sh. B. G. .

Pala paditëse thirret në nenin 124 të LMD-së, për shpërblimin e dëmit, gjë që është kërkesë e pabazuar, për shkak se për të fituar të drejtën në kompensimin e dëmit, paditësi së pari është dashur që me dëshmi të provojë se “Sh. B. G.” është e obliguar që ta përmbush një detyrim kontraktual, ndërsa nga kontrata për shitjen e materialëve të mbetura paditësit nuk i është garantuar e drejta për blerjen e ndonjë hekurishte, aq me pak e drejta për blerjen e sasisë së caktuar të hekurishteve. Përgjegjësia për kompensimin e dëmit të shkaktuar është e përcaktuar me nenin 154 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se: “Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Nga përmbajtja e dispozitës ligjore gjegjëse, rrjedh se kusht themelor për të drejtën në kompensimin e dëmit, është shkaktimi i dëmit, dhe konstatimi se kush e ka shkaktuar atë. Meqenëse paditësi nuk ka arritur të provojë se i padituri ka ndërmarrë veprimet e shkaktimit të dëmit, gjykata erdhi në përfundimin se kërkesëpatria është e pabazuar dhe të njëjtën e refuzoi në tërësi.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 78 paragrafi 1 të Ligjit Nr.L-123/për Shoqëritë Tregtare, përkatësisht nenit 75.paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-016, për Shoqëritë Tregtare - Shoqëritë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar, nenit 154paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 1, 462 paragrafi 1 dhe 463 paragrafi 2 dhe 452.2 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pala paditëse ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ae.nr.306/2018, të datë 04.08.2020, ka vendosur që të refuzojë si të pabazuar ankesën e paditëses, ndërsa aktgjykimin e atakuar të vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur përmban arsye të mjaftueshme për fakte relevante të cilat i pranon edhe kjo gjykatë ankimore, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Janë të pabazuara thëniet në ankesën e të paditurës së aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje qenësore të dispozitës nga neni 182 paragrafin 2 pika n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, se aktgjykimi ka mangësi, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe nuk ka arsye mbi fakte vendimtare. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vendimin e saj e mbështet në provat e administruara, të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Aktgjykimi i atakuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme dhe të kuptueshme për faktet vendimtare dhe nuk ekzistojnë kundërthënie mes dispozitivit të aktgjykimi dhe arsyeve të dhëna dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata Supreme e Kosovës, fillimisht me aktvendimin E.Rev.nr.75/20 të datës 01.08.2022, e ka hedh poshtë si të palejuar revizionin e paditëses: N.P.T.T “A. Xh”, me seli në fshatin B. Komuna e K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ae.nr.306/2018, të datë 04.08.2020.

Paditësi më datë 14.12.2022, në Gjykatën Kushtetuese ka ushtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit E.Rev.nr.75/20 të datës datë 01.08.2022.

Ndërsa me aktgjykimin KI199/22 të datës 30.05.2024, Gjykata Kushtetuese e ka pranuar si të bazuar kërkesën e paditësit dhe e ka kthyer në rivendosje aktvendimin e lartcekur, duke e detyruar Gjykatën Supreme të veprojë sipas aktgjykimit të saj.

Në rivendosje Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1 dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Përveç të cekurave nga dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata e shkallës së parë ka refuzuar.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses edhe për faktin se eksperti gjatë përpilimit të ekspertizës nuk ka mundur ta përcaktoj vëllimin e dëmit, që i është shkaktuar paditëses, nga se eksperti nuk ka mundur të gjejë çfarëdo dëshmie që tregon se pala paditëse ka pasur fitim të humbur. Andaj, pala e cila ka propozuar ekspertizën ka qenë e detyruar të tregoj edhe objektin dhe vëllimin ekspertizës, e nisur nga ky fakt pala paditëse nuk ka mundur të planifikoj fitim të humbur nga një punë juridike, sipas së cilës nuk ka pasur garanci, se do të blinte hekurishte në sasinë e caktuar nga "Sh. B.G., mirëpo nëse i referohemi shkresave të lëndës rezulton se pala paditëse me parashtrësë/a, si dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata në vazhdimësi plotësimin e ekspertizës financiare apo nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia financiare nga një ekspert tjetër, mirëpo gjykata e ka refuzuar kërkesën/propozimin, për plotësimin e ekspertizës apo nxjerrjen e provës me ekspertim nga një ekspert tjetër. Ndërsa në anën tjetër e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses edhe për faktin se pala paditës nuk ka arritur që të provoj me prova bazën juridike të kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsytim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pra kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga pala paditëse e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit material, për shkak të humbjes së partnerëve të tij afarist, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuese të dhënies së hekurit, të nxjerr jashtë përdorimit, dhe fitimit të realizuar nga data 19.08.2001e tutje. Po ashtu në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Kjo mënyrë e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 204 të LPK, i cili ka përcaktuar si obligim për gjykatën e shkallës së dytë që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve e të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që gjykata e shkallës së dytë vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës ligjore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 154 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia deliktore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Në këtë kontekst sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit material, për shkak të humbjes së partnerëve të tij afarist, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuese të dhënies së hekurit, të nxjerr jashtë përdorimit, dhe

fitimit të realizuar nga data 19.08.2001, e tutje, e në veçanti nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare se a janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e palës së paditur, për kompensimin e dëmit-fitimin e humbur, paditëses.

Përveç të cekurave kjo gjykatë, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të paditurës, për arsye se:

Në këtë rast duhet të ndahet pjesa e mungesës së legjitimitetit materialo-juridik (përgjegjësia në kuptimin materialo-juridik, nga mungesa e legjitimiteti proceduralo-juridik (zotësia për të qenë palë në procedurë në kuptim të nenit 73 të LPK-së, si prezumim procedural negativ, për lejueshmërinë e procesit) sepse janë dy çështje të ndara, gjë që gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Ndërsa çështjen nëse është përgjegjëse për kompensimin e dëmit - fitimin e humbur paditëses apo jo, gjykata e shkallës së parë duhet ta vërtetoj në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe provat e tjera eventuale që do ti paraqesin palët gjatë procedurës, gjë të cilën nuk e ka bërë as gjykata e shkallës së parë dhe as gjykata e shkallës së dytë.

Gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar propozimin e palës paditëse për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia finaciare, duke mos e arsyetuar refuzimin e propozimit, e që nga kjo rezulton se palës paditëse ja kanë mohuar qasjen në drejtësi, dhe pamundësinë e shqyrtimit të çështjes në gjykatë, për arsye se:

Qasja në drejtësi përbën një element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar nga neni 31 i Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe nga neni 6 i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, instrument ky drejtpërdrejtë i zbatuar në rendin tonë juridik sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, çdokush gëzon të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe se është pranuar si parakusht i të drejtës për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Pra, e drejta e qasjes në gjykatë paraqet një ndër elementet bazë të parimit të sundimit të së drejtës, për arsye se kjo u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë, për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate.

Në përgjithësi, e drejta për qasje në gjykatë garanton të drejtën për të filluar seancat gjyqësore përpara një gjykate dhe të drejtën për të marrë një vendim gjyqësor, si rezultat i diskutimeve dhe vlerësimeve të bëra pranë një gjykate të pavarur, lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile apo akuzat penale, që rëndojnë mbi subjektet e së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si vlerë të rendit juridik kushtetues ekzistues (neni 7) ka mishëruar parimin e sundimit të së drejtës (ligjit) - ku autoriteti shtetëror përveç se krijon “të drejtën”, njëkohësisht i nënshtrohet kësaj të fundit dhe e zbaton dhe detyrohet nga ajo në mënyrë të barabartë krahas subjektet tjera të së drejtës. Në këtë kontekst, garancia procedurale e qasjes në drejtësi paraqet një ndër “urat”, lidhëse midis subjektit të së drejtës që pretendon se i takon, i është shkelur, kufizuar, cenuar apo dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes i tij dhe



mekanizmave shtetërorë - gjykatat dhe/ose organet tjera të pavarura (kuazi gjyqësore) që janë të m' veshur me juridiksion dhe kompetencë, për garantimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra e drejta për qasje në gjykatë, iu jep efekt respektivisht i jetëson parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të së drejtës

Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute. GJEDNJ në çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar është shprehur se vetë natyra e saj (të drejtës për qasje në gjykatë) kërkon rregullim përkatës legjislativ (që mund të ndryshojë në kohë dhe vendndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga shteti, megjithëse rregullime të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin/esencën e së drejtës e as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ. Në këtë kontekst gjykatat e rregullta në ushtrimin e funksionit të tyre kanë për obligim që të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit, dhe Gjykata Supreme e Kosovës në këtë rast ka vlerësuar se qasja në drejtësi është parakusht thelbësor për realizimin e të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht KEDNJ.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

E.Rev.nr.26/24, datë 04.12.2024

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi